REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 312, Datë 26.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 265, DATË 11.09.2026 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "BUSHTRICA 2017" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3123/1 prot., datë 23.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 265, datë 11.09.2026 "Mbi licencimin e shoqërisë "Bushtrica 2017" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "Bushtrica 2017" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 265, datë 11.09.2026, vendosi të licencojë shoqërinë "BUSHTRICA 2017" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Bushtrica 2" me kapacitet të instaluar 4800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit, me afat vlefshmërie të licencës deri më 27.10.2052.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: *shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.09.2026*, ndërsa në pikën 3 i është lënë detyrë që: *me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga ky afat (brenda datës 30.10.2026), të përditësojë në ERE informacionin përkatës në lidhje me stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë.*

2. **Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Për vendimin nr. 265/2026 shoqëria është njoftuar me shkresën e ERE-s nr. 671/13 prot., datë 17.09.2026, ku i është sjellë në vëmendje dhe plotësimi i kushteve përkatëse.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 671/14 prot., datë 15.10.2026, shoqëria ka vënë ERE-n në dijeni të shkresës së saj nr. 042 prot, datë 09.10.2026, drejtuar MIE-s dhe AKBN-së, ku njofton se vepra është gati për kryerjen e testimeve të nevojshme.
- Me shkresën nr. 044 prot., datë 16.10.2026, të protokolluar në ERE me nr. 3123 prot., datë 19.10.2026, shoqëria "BUSHTRICA 2017" sh.p.k. ka bërë me dije se, megjithëse punimet për ndërtimin e HEC "Bushtrica 2" kanë përfunduar, për shkak të mungesës së prurjeve ujore gjatë një periudhe të zgjatur, nuk ka qenë e mundur kryerja e testimeve të nevojshme për vënien në punë të veprës. Për këtë arsye, shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 265, datë 11.09.2026, për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
- Në kushtet kur shoqëria nuk ka propozuar një afat të ri, duke marrë në konsideratë se punimet ndërtimore të HEC-it kanë përfunduar, vlerësohet që afati i ri për fillimin e ushtrimit të

veprimtarisë të jetë brenda datës 21.12.2026, me qëllim që shoqërisë t'i lihet koha e nevojshme për kryerjen e testimeve përkatëse dhe vënien në punë të veprës.

- Ndryshimi i pikës 2 sjell edhe nevojën për ndryshimin e pikës 3, ku vlerësohet të përcaktohet data 21.01.2027, si afat për përditësimin në ERE të informacionit mbi stafin teknik të angazhuar në ushtrimin e veprimtarisë.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Ndryshimi i pikës 2 sjell edhe nevojën për ndryshimin e pikës 3, ku vlerësohet të përcaktohet data 21.01.2027 si afat për përditësimin në ERE të informacionit mbi stafin teknik të angazhuar në ushtrimin e veprimtarisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 265, datë 11.09.2026, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:
   2- Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 21.12.2026.
   b) Pika 3 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:
   3- Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga afati i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi (brenda datës 21.01.2027), të përditësojë në ERE informacionin përkatës në lidhje me stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Bushtrica 2017" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut Të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI